REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRISË

## DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 53/1 Tirane, date 04/5/2016

**Drejtuar:** **Z. BILBIL HYSENAJ**
**SHOQERIA "FRALI" SHPK**
**LAGJIA "SHEQI I MADH"**
**FIER**

**Për njoftim:** **Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV**
**AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE**
**BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"**
**TIRANE**

**Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR**
**REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE**
**RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE**
**TIRANE**

**Lënda:** Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1062 date 03.08.2007

**I nderuar z. Hysenaj,**

Shoqëria "Frali" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1062 date 03.08.2007 për gëlqeror pllakore, ne objektin "Novaj" Skrapar, ne qarkun Berat.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.10889 date 30.12.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.53 date 05.01.2016, është propozuar revokimi i lejes se shfrytëzimit nr.1062 date 03.08.2007 për gëlqeror pllakore, ne objektin "Novaj" Skrapar, ne qarkun Berat, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 12014 -2015 dhe vitin 2015-2016.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur ne germën "ç" te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes**

**minerare te shfrytëzimit shfrytëzimit nr.1062 date 03.08.2007 për gëlqeror pllakore, ne objektin "Novaj" Skrapar, ne qarkun Berat**, qe shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1062 date 03.08.2007 për gëlqeror pllakorë, ne objektin "Novaj" Skrapar, ne qarkun Berat.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

**MINISTRI**

**DAMIAN GJIKNURI**